VENDIM
Nr.9, datë 17.2.2006

PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA SHOQËRIA "WONDER POWER" SHA PËR PERIUDHËN 1.1.2006 – 31.12.2006

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa b 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe vendimit nr.60, datë 29.12.2004 të Bordit të Komisionerëve "Për miratimin e të dhënave bazë në lidhje me aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël" dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.54, datë 26.09.2005 "Për afatin e shqyrtimit të aplikimeve të të licencuarve për prodhimin e energjisë elektrike nga centralet e vegjël, për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Departamenti i Tarifave dhe i Çmimeve", Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.02.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria "Wonder Power" sh.a., për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për HEC-in Bogovë,

VENDOSI:

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga shoqëria "Wonder Power" sh.a., për HEC-in Bogovë, për periudhën 1.01.2006 – 31.12.2006, të jetë 5.85 lekë/kWh.
2. Ngarkohet shoqëria "Wonder Power" sh.a. dhe KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema